



**AKTI THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË "HARMONIA 2" sh.p.k**

---

**FORMIMI**

**Neni 1**

Ne baze te ligjit nr 7638, date 19.11.1992, " Mbi shoqerite Tregtare", themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar "Harmonia 2" sh.p.k me ortak të vetëm Lavdosh CELIBASHI.

Shoqëria eshte person juridik shqiptar dhe veprimtaria e saj bazohet ne legjislacionin shqiptar, aktin e themelimit dhe statutin e saj.

**SELIA**

**Neni 2**

Selia e shoqerise "Harmonia 2" sh.p.k është në Tiranë, me adresë: sheshi "Karl Topia", rruga "Pandeli Dardha" nr.72.

Me vendim të saj shoqëria mund të vendos të hapë filiale, agjensi dhe zyra përfaqësie pa kufizim territorial.

**KOHEZGJATJA**

**Neni 3**

Shoqeria do te vazhdoje aktivitetin per nje periudhe kohore deri ne date 31 Dhjetor 2020. Ky afat mund te shkurtohet ose te zgjatet me vendim te Ortakut të Vetëm.

**ORTAKET THEMELUES**

**Neni 4**

Kjo shoqëri është themeluar nga ortakut i vetëm Lavdosh CELIBASHI i cili banon në adresën: rruga "Perlat Rexhepi", pallati UNICOM, nr.34.

Ortakut i Vetëm ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me shoqërinë "Harmonia 2" sh.p.k me dhe ndaj të tretëve.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

**Neni 5**

Objekti i veprimtarisë të shoqerisë " Harmonia 2" sh.p.k është :

1. Ndërtimi, rikonstruksioni, rinovimi, riparimi i objekteve të ndryshme industriale, të transportit, bujqësisë, ushtarake, turizmit, të banimit etj, ku përfshihen:

ndërtimi i stabilimenteve dhe/ose komplekseve të ndryshëm industrial, bujqësor dhe të shërbimit me sipërfaqe dhe lartësi të ndryshme me konstruksion dhe përbërje ndërtimore hekur, beton, xham, plastik etj;  
ndërtimi dhe riparimi i rrugëve të kategorive të ndryshme, urave, sistemeve të ujsjellësave dhe të kanalizimeve të ujrave të zeza, sistemeve të vaditjes, transportimit të energjisë elektrike, gazit dhe lëndëve të tjera djegëse;  
ndërtimi i sistemeve të transportit teleferik dhe atij detar;  
instalimi dhe riparimi i impianteve të ngrohje-ftohje, hidrosanitar, higjenike, furnizimit elektrik etj.

2. shitja dhe blerja e mallrave të ndryshme me shumicë dhe me pakicë, importim dhe eksportim i tyre, veçanërisht shitja apo blerja e ndërtimeve dhe pasurive të paluajtshme, materialeve të ndërtimit dhe/ose sistemeve të filla, etj.

## **KAPITALI I SHOQERISE**

### **Neni 6**

Kapitali themelor është 100 000 leke dhe nenshkruhet e depozitohet nga Ortaku i Vetëm.

## **KUOTAT E PJESEMARRJES**

### **Neni 7**

Kapitali themelor është i investuar në masën e plotë nga ortaku i vetëm dhe i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 1000 lekë secila.

## **ORGANET DREJTUESE**

### **Neni 8**

Vendimet e Ortakut të Vetëm, kanë fuqi detyruese për të gjithë organizmat e shoqërisë edhe pse jo të pranishëm.  
Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja Ortakut të Vetëm mund të jetë e zakonshme dhe e jashtëzakonshme.  
Shoqëria administrohet nga një Administrator. Administrator i shoqërisë "Harmonia 2" sh.p.k është Lavdosh Celibashi.  
Viti ekonomik mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti dhe bilanci duhet të aprovohet brenda 6 muajve që vijojnë.

## **NORMA TE ORGANIZIMIT**

### **Neni 9**

Normat për organizimin dhe drejtimin e aktivitetit të shoqërisë "Harmonia 2" sh.p.k dhe çështjeve të saj të brendshme janë parashikuar në statutin bashkëngjitur, i cili mund të ndryshohet në çdo moment me vendim të Ortakut të Vetëm.

**PERGJEGJESIA PERSONALE**

**Neni 10**

Prona private dhe çdo e drejte materiale ose jo, pasurore ose jo e ortakut jashte kufirit te kuotave qe ortaku i vetem zoteron ne kapitalin e shoqerise, si dhe e drejtuesit teknik, administratorit, punemarresit dhe / ose perfaqesuesit të shoqerise, jane të perjashtuara nga detyrimet e çdo lloji qe rendojne mbi shoqerine.

**DISPOZITA TE FUNDIT**

**Neni 11**

Ky akt eshte redaktuar ne pese ekzemplare dhe nenskruhet me vullnet te lire nga ortaku i vetem.

**Ortaku i vetem**

**Lavdosh CELIBASHI**




**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**Dhoma e Noterëve Tirane.**

Nr...1186... Rep

Nr...49... Kol.


**VERTETIM**

Sot në ..22..Shtator 2004 (dy mijë e katër ), para meje noterit M. Lleshi anëtare e dhomës së noterëve Tiranë, u paraqit personalisht Ortaku i Vetëm themelues i Shoqerisë "Harmonia 2 " sh.p.k, Lavdosh CELIBASHI, me zotësi të plotë për të vepruar , i panjohur me parë personalisht prej meje, për identitetin e plotë të të cilit u sigurova në bazë të dokumentit identifikuese pasaportë me nr Z.100.1300, i cili deklaroi se jashtë kësaj zyre, me vullnetin e tij të plotë të lirë, ka formuluar këtë statut, dhe unë noteri duke e gjetur konform ligjit e vertetojë atë.



**NOTERI**

Noteri  
Majlinda Lleshi  
TEL 3564234555



## STATUT

**I shoqërisë "Harmonia 2" sh.p.k**

---

### KAPITULLI I

#### DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

##### FORMA JURIDIKE DHE EMËRTIMI I SHOQËRISË

###### Neni 1

Ne bazë të ligjit nr 7638 date 19.11.1992 "Mbi shoqëritë tregtare" dhe shtesave e ndryshimeve të bëra këtij ligji, si dhe aktit të themelimit të ortakut të vetëm është krijuar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "**Harmonia 2" sh.p.k.**

Kjo shoqëri fiton të drejtat dhe detyrimet si person juridik dhe fillon ushtrimin e aktivitetit të saj me rregjistrimin në organet përkatëse kompetente.

Shoqëria ushtron aktivitetin në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese të saj (akt - themelimi dhe statut)

##### SELIA E SHOQËRISË

###### Neni 2

Selia e shoqërisë "Harmonia 2" sh.p.k është në Tiranë, me adresë: sheshi "Karl Topia", rruga "Pandeli Dardha" nr.72.

Me vendim të saj shoqëria mund të vendos të hapë filiale, agjensi dhe zyra përfaqësie pa kufizim territorial.

##### KOHËZGJATJA

###### Neni 3

Shoqëria do të vazhdojë aktivitetin për një periudhë kohore deri në datë 31 Dhjetor 2020. Ky afat mund të shkurtohet ose të zgjatet me vendim të ortakut të vetëm.

##### ORTAKËT

###### Neni 4

Kjo shoqëri është themeluar nga ortaku i vetëm Lavdosha CELIBASHI i cili banon në adresën: rruga "Perlat Rexhepi", pallati UNICOM, nr.34.

Ortaku i Vetëm ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me shoqërinë "Harmonia 2" sh.p.k me dhe ndaj të tretëve.

## OBJEKTI I VEPRIMTARISË

### Neni 5

Objekti i veprimtarisë të shoqërisë "Harmonia 2" sh.p.k është :

1. Ndërtimi, rikonstruksioni, rinovimi, riparimi i objekteve të ndryshme industriale, të transportit, bujqësisë, ushtarake, turizmit, të banimit etj, ku përfshihen:  
ndërtimi i stabilimenteve dhe/ose komplekseve të ndryshëm industrial, bujqësor dhe të shërbimit me sipërfaqe dhe lartësi të ndryshme me konstruksion dhe përbërje ndërtimore hekur, beton, xham, plastik etj;  
ndërtimi dhe riparimi i rrugëve të kategorive të ndryshme, urave, sistemeve të ujsjellësave dhe të kanalizimeve të ujrave të zeza, sistemeve të vaditjes, transportimit të energjisë elektrike, gazit dhe lëndëve të tjera djegëse;  
ndërtimi i sistemeve të transportit teleferik dhe atij detar;  
instalimi dhe riparimi i impianteve të ngrohje-ftohje, hidrosanitar, higjenike, furnizimit elektrik etj.

2. shitja dhe blerja e mallrave të ndryshme me shumicë dhe me pakicë, importim dhe eksportim i tyre, veçanërisht shitja apo blerja e ndërtimeve dhe pasurive të paluajtshme, materialeve të ndërtimit dhe/ose sistemeve të tilla, etj.

## KAPITULLI II

### KAPITALI DHE KUOTAT E SHOQERISE

#### KAPITALI THEMELOR

##### Neni 6

Kapitali themelor është 100 000 lekë i investuar në masën e plotë dhe është i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 1000 lekë secila.

Kapitali themelor mund të shtohet ose ndryshohet vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm sipas legjislacionit në fuqi.

Kuotat janë nominative dhe nuk mundet asnjëhere të prezantohen nga letra me vlerë. Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

#### KUOTAT E PJESEMARRJES

##### Neni 7

Ortaku i vetëm është zotëruar i të gjithë kuotave të shoqërisë "Harmonia 2" sh.p.k.

#### TRANSFERIMI I KUOTAVE

##### Neni 8

Kuotat e kapitalit janë lehtësisht të transferueshme dhe mund të transferohen në çdo moment sipas ligjit shqiptar në fuqi.

Transferimet e pjesëve të kapitalit themelor duhet të vërtetohen me akt noterial.

Shoqëria dhe të tretët duhet ti respektojnë këto transferime sapo marrin dijeni për to.

Transferimi i kuotave mundet të bëhet vetëm me vendim të Ortakut të vetëm.

### KAPITULLI III

## MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQËRISË

### ORTAKU DHE VENDIMET E TIJ

#### Neni 9

Vendimet e Ortakut të Vetëm, kanë fuqi detyruese për të gjithë organizmat e shoqërisë edhe pse jo të pranishëm.

Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja Ortakut të Vetëm mund të jetë e zakonshme dhe e jashtëzakonshme.

Mbledhja e zakonshme vendos për çështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertët kontabël të autorizuar dhe likujduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i llogarive vjetore, ndarja e fitimit etj. Ortaku i vetëm në mbledhjen e jashtëzakonshme vendos për çështje të tilla si ndryshimet e statutit, zvogelimi i kapitalit themeltar, transferimi i pjeseve të kapitalit themeltar tek të tretet, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në forma të tjera etj.

Proçes Verbalet e mbledhjes përpilohen , aprovohen dhe firmosen nga ortaku i Vetem, kur nuk përpilohen nga një noter.

### ADMINISTRIMI

#### Neni 10

Shoqëria administrohet nga një Administrator. Administrator i shoqërisë "Harmonia 2" sh.p.k është Lavdosh Celibashi.

Administratori (në rastin kur nuk është ortaku i vetëm) emërohet me vendim të Ortakut të vetëm dhe për një periudhë jo më shumë se tre vjet.

Si rregull Administratori përfaqëson shoqërinë në marrdhënie me të tretët brënda kufijëve që i njej ligji dhe ky statut.

#### Neni 11

Ne marrëdhënie me Ortakun dhe të tretët Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e administrimit në interes të Shoqërisë edhe në emër të saj, nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e shoqërisë duke përjashtuar ato kompetenca që ligji dhe statuti i shoqërisë ua japin shprehimisht Ortakut.

#### Neni 12

Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve, në rastet e shkeljes së ligjit apo statutit të kryera këto gjatë administrimit.

Administratori mund të blejë, të shesi, ndryshojë pasuri të tundshme , vetura dhe makina, të blej tituj aksionesh, të marrë përsipër pjesëmarrje aksionare ose kapitale në shoqëri tregtare të çfarëdo lloji , të bleje pasuri të tundshme dhe të patundëshme.

Për vlefshmërine e vendimeve të Administratorit kërkohet prania e 100% të Kuotave të Ortakut të Vetem.

### EKSPERTET KONTABËL TË AUTORIZUAR

#### Neni 13

Në rast nevoje ose nëse e kërkon ligji , kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar i emëruar për tre vite financiare.

Eksperti kontabël emërohet dhe shkarkohet nga Ortaku i vetëm.

#### DREJTUESI TEKNIK

##### Neni 14

Drejtimi Teknik i shoqërisë në realizimin e objektit të veprimtarisë së saj të parashikuar në statutin e shoqërisë do të realizohet nga drejtuesi teknik i saj.

Drejtes teknik i shoqërisë "Harmonia 2" sh.p.k është Lavdash Celibashi i cili zotëron licensën e dhënë nga Ministria e Rregullimit të Territorit me nr. Z 0092/4 datë 01.04.2004.

Drejtes teknik emërohet me vendim të Ortakut të vetëm

### **KAPITULLI IV**

#### **VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE**

##### VITI FINANCIAR

##### Neni 15

Çdo vit financiar fillon në 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht, nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga Mbledhja e Ortaku i Vetem.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarin vjetore bëhet brenda një afati të caktuar prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

##### DIVIDENTËT

##### Neni 16

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistences së fitimeve, Mbledhja e Ortakut të vetëm percakton pjesën që i takon atij në formën e dividendeve mbi fitimin. Fitimi, që do të ndahet nga Ortaku, në proporcion me pjeset e kapitalit themeltar, përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për fondin rezerve të domosdoshëm ( 5% e fitimit te cdo viti deri sa ky fond te arrije vleren e 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

### **KAPITULLI V**

#### **ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

##### ZGJATJA E AFATIT

##### Neni 17

Me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 3 të këtij statuti, zgjatja e tij mund të vendoset nga Mbledhja e Ortakut të Vetëm. Vendimi përkatës depozitohet në regjistrin përkatës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

## PRISHJA E SHOQËRISË DHE LIKUJDIMI

### Neni 18

Shoqëria priset në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 3 të këtij statuti, me përjashtim të rasteve ku bëhet zgjatja e afatit, ose kur ka një prishje të parakohshme për arsye të parashikuara me ligj.

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Mbledhja e ortakut të Vetëm emëron një ose disa likuidues.

### Neni 19

Likuiduesit brenda 6 muajve nga data e emerimit, para se të fillojë operacioni i likuidimit, paraqesin raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe të pasivitetit të shoqërisë.

Likuiduesi përfaqëson shoqërinë dhe ka të gjitha kompetencat e nevojshme për likuidimin e aktivitetit dhe pasivitetit të saj. Ai është i autorizuar të paguaj të gjithë kreditorët.

Pasi mbyllet të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj të tretëve likuiduesi i jep kapitalet e mbetura Ortakut të Vetëm.

Aktet e mbylljes së likuidimit së bashku me llogaritë përkatëse përfundimtare depozitohen në Regjistrin Tregtar.

Mbas mbylljes së likuidimit dhe depozitimit të dokumentacionit në Regjistrin Tregtar, shoqëria ç' regjistrohet prej tij.

## **KAPITULLI VI**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

#### SHNDËRRIMI I SHOQËRISË

### Neni 20

Shndërrimi i shoqërisë me përgjegjesi të kufizuar në shoqëri kolektive ose në shoqëri komandite anonime mund të kryhet me miratim të Ortakut të Vetëm.

#### MOSMAREVESHJET

### Neni 21

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë, ose gjatë periudhës së likuidimit, ndërmjet shoqërisë dhe Ortakut, do të paraqiten për zgjidhje Gjykatës kompetente, që do të jetë Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë.

## HYRJA NË FUQI



Neni 22

Statuti hyn në fuqi mbas miratimit dhe regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Ky statut është hartuar në pesë kopje origjinale dhe nënshkruhet me vullnet të lirë nga Ortaku i vetëm.

ORTAKU I VETËM

Lavdosh CELIBASHI



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
Dhoma e Noterëve Tirane.

Nr...186... Rep

Nr...49... Kol.

VERTETIM

Sot në ..22 Shtator 2004 (dy mijë e katër ), para meje noterit M. Llopi anëtare e dhomës së noterëve Tiranë, u paraqit personalisht Ortaku i Vetëm themelues i Shoqërisë "Harmonia 2" sh.p.k, Lavdosh CELIBASHI, me zotësi të plotë për të vepruar , i panjohur me parë personalisht prej meje, për identitetin e plotë të të cilit u sigurova në bazë të dokumentit identifikues pasaportë me nr L1001300, i cili deklaroi se jashtë kësaj zyre, me vullnetin e tij të plotë të lirë, ka formuluar këtë statut, dhe unë noteri duke e gjetur konform ligjit e vertetojë atë.

NOTERI

